

## **Rregullore plagjiaturë në Kolegjin Tempulli**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Përmes kësaj rregullore Kolegji Tempulli Akademinë Tempulli (në tekstin e mëtejme Kolegji) do të përkushtohet dhe të sigurojë që punët e bëra nga studentët të jenë të bazuara në punën e tyre.

Përmes kësaj rregulloreje Kolegji do të përkushtohet që të sigurojë se:

- Raste e plagjiaturës
- Marrëveshjet/bashkëpunimet e fshehta dhe
- Aktet tjera të mashtrimit

nuk do të jenë prezent dhe në rast se ekziston diçka e tillë do të dënohen përmes procedurave disiplinore.

### **Neni 2**

#### **Çka është plagjiaturë**

Duke u bazuar në Rregulloren e Kodit të Etikës të Kolegji, neni 20, plagjiatura definohet si: përdorimi i fjalëve, ideve, koncepteve ose të dhënave të një personi tjetër pa e cituar. Plagjiatura mund të ekzistojë në rrethana ku studenti thotë se ai/ajo është burimi origjinal i informacionit. Plagjiatura përfshinë përdorimin e drejtpërdrejtë dhe parafrazimin e fjalëve, mendimeve ose koncepteve të tjetrit pa cituar.

### **Neni 3**

#### **Marrëveshjet/bashkëpunimet e fshehta**

Marrëveshjet dhe bashkëpunimet e fshehta i referohen kur dy ose më shumë student bashkëpunojnë në mes veti në një punim dhe njëri dorëzon të njëjtin punim në një lëndë ndërsa tjetri në një lëndë tjetër, duke i dhënë njëri punimin tjetrit për dorëzim në lëndë të njëjtë, duke e

dorëzuar të njëjtin punim më shumë se njëherë, duke marrë punime të njëjta nga akademitë, universitet tjera dhe duke i paraqitur si të veta etj.

Në rastet kur ka provime, kollokfiume etj, dhe studentëve iu kërkohet të punojnë në mënyrë individuale, ata e kanë të ndaluar të bashkëpunojnë ndërmjet veti.

Në raste kur kanë detyra të shtëpisë, seminare etj, dhe atyre iu kërkohet të punojnë në mënyrë individuale, atëherë ata e kanë të ndaluar të komunikojnë ndërmjet veti dhe të diskutojnë ide, të ndajnë materiale etj.

Në raste kur puna është në grup atëherë studentët në grup duhet të marrin përgjegjësi dhe të punojnë në mënyrë të barabartë duke e ditur secili kontributin në punim dhe në mënyrë individuale secili të prezantojë punën e tij/saj.

#### **Neni 4**

#### **Akte tjera të mashtrimit**

Studentët duhet të tregojnë saktë burimet të cilat i përdorin në shkrimet apo punimet e tyre. Studentët gjatë shkrimit të punimit, temën e diplomës etj, duhet të citojë në mënyrë adekuate burimet e marra dhe se citimet duhet të jenë të sakta nga ku i merr.

#### **Neni 5**

#### **Plagjiaturë e vogël dhe e madhe**

Në Akademi, plagjiatura mund të konsiderohet e madhe dhe e vogël.

Plagjiaturë e madhe përfshinë rastet kur:

1. Marrja ose kopjimi i një sasive të konsiderueshme të tekstit, diagrameve, tabelave, imazheve etj, nga çdo material i printuar ose elektronik.
2. Mos parafrazimi i teksteve por kopjimi i tyre duke i ndryshuar vetëm disa fjalë apo duke ndryshuar renditjen e tyre, apo duke ndryshuar vetëm disa fjalë në tabela apo edhe rishkrim të tyre, ri vizatim i diagrameve etj.
3. Përvetësimi i dizajnëve dhe koncepteve dhe duke i prezantuar ato si plotësisht/pjesërisht si të veta.

Plagjiaturë e vogël përfshinë rastet kur:

1. Mos citimet e teksteve, fjalëve, etj, ose citime jo të plota.
2. Parafrazime të papërshtatshme (zëvendësim i vetëm disa fjalëve në tekst të njëjte).
3. Burime e citimit të pa identifikuar
4. Gabime në listën e referencave dhe citimeve në tekst duke krijuar mospërputhje me njëra tjetrën etj.

## Neni 6

### Kontrollimi i plagjiaturës dhe procedurat

Kolegji, ofron njërin nga programet (PlagiarismCheck) për kontrollimin e plagjiaturës ku do të kenë qasje profesorët dhe studentët. Raportet e kontrollit të plagjiaturës duhet të dorëzohen nga studentët tek profesorët përkatës të cilat më pas i dërgohen koordinatorit të programit.

Në rast se dyshohet për plagjiaturë apo ka ndodhur plagjiatura atëherë duhet të raportohet tek Sekretarja e Kolegjit për procedurë të mëtutjeshme. Komiteti i Etikës pas denoncimit për plagjiaturë fillon shqyrtimin nga evidencat e ofruara duke u bazuar në Rregulloren për Kodin Etikës.

## Neni 7

### Ndëshkimet për plagjiaturë

Kolegji në rastet e plagjiaturës do të merr masa ndëshkimore varësisht nga lloji i plagjiaturës dhe frekuenca e shkeljeve. Në tabelën në vijim është janë dhënë ndëshkimet.

Ndëshkimet për plagjiaturë			
	Shkelje e parë	Shkelja e dytë	Shkelja e tretë
Plagjiaturë e vogël	Nëse punimi i studentit ka plagjiaturë të masës së vogël atëherë nuk notohet. Notimi bëhet vetëm nëse punimi i tij është origjinal. Në raste të tilla studentit i krijohet dosja dhe regjistrohet sjellje jo e mirë akademike.	Nëse studenti përsërit plagjiaturën për herën e dytë atëherë ai merre paralajmërim me shkrim për sjellje jo të mirë akademike. Në dosjen e tij regjistrohet sjellje jo e mirë akademike për herë të dytë.	Nëse studenti përsërit plagjiaturën për herën e tretë atëherë studentit duhet të përsërit lëndën në vitin/semestrin tjetër. Nëse ka ndodhur në shumë lëndë atëherë mund të ndodhe që të përsërit gjithë semestrin.
Plagjiaturë e madhe	Në raste të tilla studentit merr paralajmërim me shkrim për sjellje jo të mirë akademike. Hynë në rivlerësim të punimit, lëndës etj.	Nëse studenti përsërit për herë të dytë atëherë merr paralajmërim me shkrim për sjellje jo të mirë akademike. Studenti lëndën e përsërit në vitin/semestrin tjetër.	Përfundimi i studentit nga Akademia

		Studenti paralajmërohet se nëse përsërit për herën e tretë përjashtohet nga Akademia	
--	--	--	--

**Neni 8**  
**Dispozita kalimtare**

Kjo rregullore hyn në ditën e miratimit nga ana e Këshillit Akademik. Rregullorja mund të ndryshohet në të ardhmen nëse paraqitet nevoja për një gjë të tillë.

Kryesuesi i Këshillit Akademik

Dr.Sc.Meylan Bixhaku

